

MUHAMET TARTARI
HISTORI NË POLIFONI
STUDIME, ARTIKUJ, ESE, KËNGË

BOTIMET TOENA

MUHAMET TARTARI
Mjeshtëtër i Madh

HISTORI NË POLIFONI

Studime, artikuj, ese, këngë

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2020



Bashkia Vlorë

Ky libër botohet me mbështetjen e Bashkisë së Vlorës, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, z. Dritan LELI.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor shkencor: prof. dr. Bardhosh Gaçe

Redaktor: dr. Alban Tartari

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

Foto në kopertinë: Alban Tartari, Grupi Polifonik i Vranishtit duke performuar vallen “Prapa më vjen historia”, në koncertin festiv organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhjetor 2011, Pallati i Kongreseve, Tiranë.

ISBN 978-9928-327-17-8

© Alban Tartari, Borana Tartari Meço

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

Botimet TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Këtë libër ua kushtoj me shumë dashuri
shtatë mbesave dhe nipërve të mi:
Esra Tartari, Adli Tartari, Erida Tartari, Leila Meço,
Daris Tartari, Amina Tartari, Nalti Meço.

Autori

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	11
Parathënie.....	13

PJESA E PARË HAPA NË HISTORI

Epika popullore mbi luftërat heroike të shqiptarëve - Lidhja e Prizrenit dhe periudha në vijim.....	21
Lufta e Vlorës në këngën tonë popullore.....	28
Lufta e fshatarësisë së Vlorës kundër sundimit osman gjatë periudhës së Rilindjes	37
Si i ka përjetësuar lumi i Vlorës historinë dhe luftëtarët e vet në këngët e tij.....	46
Mbi traditat kulturore të fshatit të Vranishtit	52
Sali Vranishti dhe jehona e tij në këngë.....	62
Kapedan more Zigur, çave para me flamur!.....	70
Sali Hallkokondi dhe vepra e tij “Historia e Shqipërisë së re”	76
Shaban Seferi e meritonte botimin e poezisë së tij	79
Hysen Çino u bë këngë në breza.....	81
Rrapo Meto Prëmtaj - atdhetar i zjarrtë dhe këngëtar popullor ...	86
Xhemil Veli Duka - atdhetari, mësuesi, këngëtar	92
Në gjurmët e mësuesit të nderuar Besim Feimi	96
Shkolla e Vranishtit dhe grupi polifonik, Vatra të edukimit dhe kulturës.....	99

PJESA E DYTË
UDHËTIM NË POLIFONI

Variantet e këngës dhe valles së Vranishtit.....	107
Historik i shkurtër i valles së burrave të Vranishtit.....	111
Veçoritë e këngës dhe të valles vranishjote.....	114
Polifonia labe e Vlorës dhe vlerat artistike dhe historike të saj .	120
Ansambli i shtetit dhe vallja “Sup më sup të lidhur jemi”	124
“Europa për mbrojtjen e folklorit”	127
Si e kanë pritur të huajt këngën labe.....	130
Vranishti i këngës dhe kënga e Vranishtit.....	134
Në emër të atyre që shpirti u pikon mbi penë	139
Si lindi një këngë	142
Ali Asllani, mësuesi dhe frymëzuesi im	145
Ç’mori dhe sa i dha poezisë popullore labe poeti Ali Asllani....	147
Bejkë e bardhë.....	150
Gjithë jetën këngë ke mbjellë	153
Libri i Haxhi Dalipit, vlerë studimore në fushën e etnomuzikologjisë	155
Lapardhaja, ku lulet kullojnë këngë dhe mjaltë.....	160
Udhëtim në këngën e Bënçës së Tepelenës.....	165
Vranishti në sytë e gazetarit Duro Mustafai.....	169
Polifonia e sportistëve bolenas.....	172
Në librin e Servet Tartarit.....	172
Vendlindja përherë e dashur e fisnike	175

PJESA E TRETË
FLUTURIM NË KËNGË

Plaku thinjabardhë	181
Kënga hapëse e koncertit “Labëria për Kosovën”	183
Gëzuar 100-vjetor	187
Hapet vallja labërishte.....	188
Fluturon Ultimatumi	189
Këngët brez pas brezi rriten	190
Rrofsh o Shqipëria ime	192
Vaçe, ç’këngë kombit i fale.....	194
Shpirti të pikon mbi penë.....	196
Ne për ju ngremë dollinë.....	197
Mirë se vjen në sofrën labe	198
Këngë për Ali Podrimjen	199
Këngë për atdhetarin Nexhip Alban.....	200
Bilbili me zë të rrallë.....	202
O hero Halil Hasani	203
Azem Sulo, trim i rrallë	204
Emri yt, emër i lartë, atdhetari Maman Saliu.....	205
Komandant Çobo Osmëni.....	207
Gjithë bilbilat në një këngë.....	208
Haxhi Dalipi i çdo kënge	219
Fjala jote - peshë sa mali.....	222
Vargje për Ismet Elezin.....	223
Homazh për Kujtim Micin.....	224
Pena e artë e Maliq Lilës.....	225
Këngë malesh, vallesh, detesh	227
Mejdi Skëndo burrë nderi	228
Bilbilat e Golëmit.....	229
Homazh.....	230

Kurvelesh balli në yje	234
Tragjasi i dijes	236
Vajza himarjote	237
Himarë traditë-arta	238
Thëllëzës së shkruar-ë	239
Fushën edhe malin, o sa shumë i dua.....	240
Xha Besim për ty nderimi	242
Për Agron Haxhinë.....	243
Hape portën moj Evropë	244
Qyteti Horë-Vranisht.....	245
O Vranisht i këngëvè.....	246
Zërin mora në bilbilë.....	247
Jetëshkrim	249
Abstract	253

Hyrje

Nga akademik prof. dr. Vasil S. Tole

Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Zakonisht hyrjet bëhen për të futur në temë lexuesin e panjohur me lëndën që libri sjell më pas, e në këtë kuptim ato janë si një lloj urimi mirëseardhjeje, i ngjashëm me formulat që zakonisht i zoti i shtëpisë i drejton me dorë në zemër e me gaz në buzë mikut, apo miqve që pret te dera e shtëpisë. I tillë më duket vetja mua sot, si një zot shtëpie imagjinar, i cili fton miq e kalimtarë (në këtë rast lexues), për t’u kthyer nga rruga e për të qëndruar një copë herë e për t’u çlodhur e soditur në faqet e këtij libri, për t’u njohur me të zotin e vërtetë të librit-shtëpi, Muhamet Tartarin, këtë “këmbë mali” Labërie e shqiptarie.

E vërteta kërkon të thuhet që për Muhametin tonë nuk ka shumë nevojë të flitet gjatë, pasi koha dhe historia ka folur e shkruar për të, madje ai, ndryshe nga shumica që kanë veç jetën fizike, ka disa jetë: jetën si bartës e mbledhës folklori, si rapsod e poet, si këngëtar e valltar, si arsimtar e gazetar, drejtues e organizator i artit dhe i kulturës, pa folur për jetën e përjetshme të artit të tij që rron e përcillet më tej sa herë që kënga dhe vallja labe kërcëhet e këndohet.

Të gjitha sa më sipër, ju, të dashur miq të fjalës dhe të tingullit, do t’i konstatonit sapo të filloni të shfletoni me kërshtëri faqet e këtij libri, i cili nuk është shkruar siç shkruhen zakonisht librat. Para se faqet e këtij libri të ishin së bashku, ato ishin të shpërndara fije-fije si pjesë e peizazhit kulturor që Muhameti formoi me talentin, jetën

dhe veprimtarinë e tij krijuese mbi 50-vjeçare për njerëzit. Prandaj, ato vijnë te ne ashtu siç vijnë flora dhe fauna erëmirë e natyrës shqiptare, të cilat sjellin me vete gjithë elementet e botës krijuese që ka për autor Muhametin. Ajo është një botë që ju mirëpret krahëhapur, sepse krijuesi i saj është mbi të gjitha njeri me zemër të madhe dhe me shpirt tradite e mikpritjeje.

Muhameti mban emrin e profetit dhe si mbiemër ka emrin e një mali. Kështu është edhe jeta e tij. E lartë dhe e rëndë si mali nga rëndësia dhe shpirtërore, me paqe e bekim nga brendia e emrit të tij.

Prandaj unë, miku i vjetër i tij, ju ftoj me dorë në zemër ta prekni edhe ju magjinë krijuese të Muhametit tonë, këtij “Mjeshtri të Madh”, i cili është njëherazi traditë dhe risi e trashëgimisë kulturore shpirtërore të Labërisë sonë.

Dera për ju është e hapur, hyni, hyni brenda saj, Muhameti ju pret siç di vetëm ai!

Tiranë, më 15 korrik 2020

Parathënie

Muhamet Tartari, bardi i shquar popullor i Vranishtit Nga prof. dr. Bardhosh Gaçe

Në traditën tonë të këngës polifonike në Labëri, herë-herë kanë nxjerrë krye edhe personalitete të shquara krijuese dhe ekzekutuese, të cilat kanë lënë gjurmë të thella në zhvillimin dhe pasurimin e visarit tonë popullor. Labëria përherë ka qenë një vatër e ndezur, ku kënga polifonike ka përcjellë nëpër kohë vlera të rralla artistike dhe estetike.

Në këtë traditë të pasur folklorike, emra të tillë rapsodësh e bartësish popullorë si: Ali Dinua në Gusmar, Tartar Zeka në Kuç, Neço Muka në Himarë, Maliq Lila në Bençë, Lefter Çipa në Pilur, Selim Hasani në Brataj, Kujtim Mici në Tërbaç, Hamdi Pulaj në Tragjas, Dule Havari në Dukat, Pelivan Bajrami në Drashovicë, Teno Lena në Fterrë, me krijimtarinë e tyre poetike dhe gjallërimin e folklorit janë bërë zëra të fuqishëm të përcjelljes së kësaj pasurie shpirtërore.

Midis tyre, një vend të nderuar zë edhe rapsodi popullor Muhamet Tartari, “Mjeshtër i Madh” nga Vranishti i Vlorës, me krijimtarinë e tij të begatë folklorike. Ai lindi dhe u rrit në një trevë mjaft të pasur folklorike, e cila ka frymëzuar përherë bardin për të krijuar këngën e tij, e cila është e përhapur në tërë Labërinë dhe vise të tjera. Sa herë kemi shkuar në Labëri me Tish Dainë, Qemal Haxhihasanin, Rrok Zojzin, Beniamin Krutën, Haxhi Dalipin etj., në Vranisht kemi gjetur përherë një krua të madh të këngës labe.

Përgjatë shekullit XX e deri në ditët tona, nga gjiri i këtij fshati kanë dalë rapsodë, këngëtarë, valltarë dhe instrumentistë të talentuar. Kënga dhe vallja labe që thurën dhe ekzekutuan rapsodët, valltarët e këngëtarët e famshëm të këtij fshati si: Tare Selmani, Çelo Jonuzi, Murat Tartari, Rrapo Meto dhe Xhemil Duka, në fillim të shek. XX, krijoi një vatër të zjarrtë ku u ushqyen breza të tërë rapsodësh, këngëtarësh e valltarësh. Poeti popullor Muhamet Tartari gjatë pesë dekadave të fundit, duke gjurmuar këtë traditë të mrekullueshme folklorike, qysh në vitet '70 të shek. XX, kur sapo kishte kryer studimet e larta për Histori-Gjeografi në Universitetin e Tiranës, ashtu si mjaft mësues të tjerë në Labëri, thuri vargjet e para poetike sipas traditës folklorike të kësaj treve.

Krahas botimit të krijimtarisë së tij poetike në vëllimin “Vallja e Vetëtimave”, Muhamet Tartari grumbulloi një material mjaft të pasur folklorik në Vranisht dhe në fshatrat e Lumit të Vlorës; balada, këngë historike dhe lirike, fjalë të urta e frazeologji, rite e zakone, të cilat e pasuruan më tej edhe vetë krijimtarinë e tij poetike. Në fondin e tij përmbledhen mbi 1500 këngë, 800 fjalë të urta, mbi 400 faqe studime etnografike, historike dhe folklorike si: “Humori dhe satira në këngët popullore labe”, “Kontributi i Xhemil Veli Dukës në folklorin e Labërisë”, “Vallja e Vranishtit dhe evoluimi i saj”, “Rapsodët e hershëm, të Lumit të Vlorës”, “Vizita e Ismail Qemalit në Vranisht në vargjet popullore”, “Kapedan Sali Vranishti - monument i gjallë në këngën labe”, “Veçori të veshjes popullore në Vranisht”, e mjaft të tjera, në të cilat sillen si dëshmi e bëhen mjaft analiza për lashtësinë dhe traditat e banorëve të kësaj treve.

Muhamet Tartari një jetë të tërë i shërbeu me përkushtim zhvillimit të arsimit kombëtar në Lumin e Vlorës, për disa dekada edhe si drejtor i shkollës së mesme në Horë të Vranishtit. Si organizator i talentuar i orës së mësimin, i nxiti nxënësit të fitonin njohuri të thella për gjeografinë dhe historinë e Shqipërisë dhe të Europës, luftërat

dhe përpjekjet e shqiptarëve për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut. Në këtë aspekt, një fushë e gjerë e veprimtarisë gjurmuese e krijuese e Muhamet Tartarit është edhe pjesëmarrja e tij në simpoziume dhe konferenca shkencore në Vlorë dhe në Institutin e Historisë dhe Kulturës Popullore në Tiranë, ku ka shpalosur mendimin e tij për historinë e Labërisë dhe frymëzimin artistik popullor.

Poeti popullor Muhamet Tartari, e pasuroi më tej traditën e hershme të këngës dhe valles vranishiote, në vitet '70 të shek. XX, i dha një vullë të re. Në krye të grupit polifonik dhe valltarëve virtuozë të këtij fshati, ai shtegtoi për katër dekada nëpër skenat e festivaleve folklorike në Vlorë, Gjirokastrë, Lezhë, Berat, por edhe në një varg vendesh europiane: Greqi, Kosovë, Francë, Turqi, Moldavi, Gjermani, Holandë, Itali e gjetkë, ku shfaqti vlerat e rralla të polifonisë labe. Në këtë pasuri të çmuar, ai ngriti mbi 800 tekste këngësh, jo vetëm për grupin polifonik të Vranishtit, por edhe për mjaft grupe të tjera në Mesaplik e Lumin e Vlorës, Himarë, Kurvelesh, Gjirokastrë, Zagori, Mallakastër e deri në Ansamblin e Këngëve e Valleve Popullore në Tiranë.

Bota poetike e këngës së Muhamet Tartarit me frymëzimet e veta brilante, shpalos ndjenja e përjetime të fuqishme mbi bëmat dhe historinë e shqiptarëve, prijësat dhe kryetrimat e saj si: Zenel Gjoleka, Hodo Nivica, Sali Murati, Rrapo Hekali, Tafil Buzi, Nase Beni, Hysen Çino, Azem Sulo, por në mjaft vargje zbulohet edhe shpirti i tij i thellë lirik. Mjaft prej këtyre këngëve ende bëjnë një jetë të gjallë folklorike, ato këndohen nëpër dasma e gëzime familjare, nëpër koncerte e festival të ndryshme, edhe poeti mbetet anonim.

Në këngët lirike të dashurisë, poeti popullor Muhamet Tartari, me frymëzimin e tij të thellë krijoi një cikël të tërë si: “O çoban që mposht stuhinë”, “Moj kuarca gushëbardhë”, “Syzeza nishan me pika”, “Minushe vetull kabule”, “Moj e vogëla si ari”, “Do

kaptoj male dhe dete”, “Gushëbardha - vetullhënë” e të tjera, të cilat gjetën përhapje edhe në dasma e ceremoni festive. “Mjeshtri i Madh” Muhamet Tartari, në zhvillimin dhe pasurimin e polifonisë labe ka dhënë një kontribut të veçantë edhe me ringjalljen e valles karakteristike të Vranishtit. Duke u mbështetur në traditën e kësaj valleje në vendlindjen e tij, ai e çoi më tej atë, përplasja e këmbëve fort në tokë, u jep vargjeve të kënduara një jehonë përcjellëse. Lëvizja e këmbës në formën e një shpate të mprenjtë majtas e djathtas, shoqërohet edhe me rrotullimet valltarëve virtuoze. Këmbëngulja e këtij mjeshtri të polifonisë labe, bëri të mundur edhe kërcimin e valles së kënduar duke ecur në gjunjë, e cila shoqërohet edhe me kërcimin e befasishëm të valltarëve.

Siç vë në dukje etnomuzikologu Ramadan Sokoli dhe studiuesi Benjamin Kruta, vallja e Vranishtit pësoi një përhapje të gjerë duke u kërcyer në fshatra të tjerë. Valle të tilla si: “O trima vallen ma mbani”, “Shpata jonë gris fermanë”, “Gjithë shqiptarët rreth flamurit”, “Shqipëri flamur qëndrese”, “Labëri dyzet kështjella” etj, kanë krijuar vlera të reja interpretimi. Një ndikim të fuqishëm në krijimtarinë e poetit popullor Muhamet Tartari pati gjyshi i tij Murat Tartari, rapsod dhe valltar i njohur në Labëri, por edhe Mësuesi i Merituar Xhemil Veli Duka, si dhe poeti dëshmor Shaban Seferi.

Ky ndikim duket qartë në të gjithë botën poetike të Muhamet Tartarit, sidomos në të thururit e këngës dhe vargjeve të valles me 5-7-9 e rrallë me 11-13 vargje, futjen e refrenit dhe përsëritjen e tij dy e tri herë, si dhe në ndërtimin e vargjeve me rimë të puthur. Vargjet poetike të këngëve e valleve polifonike të Muhamet Tartarit gjëmojnë e bubullojnë me një kolorit të ri nga këngëtarët dhe valltarët virtuoze: Hetem Shkurtaç, Arap Çeloleskaj, Spiro Çino, Zihni Janushi, Bashkim Canodenaj, Jazo Hibri, Selman Alia, Lesko Çeloleskaj, Çane Mënaj, Sinan Gjoleka, Bilbil Basho, Shyqyri Aliaj, Kastriot Himaj, Baftjar Kanani, Ismail Shakaj e mjaft të

tjerë, të cilët i ekzekutuan me mjeshtëri e virtuozytet. Krijimtaria poetike e rapsodit të talentuar Muhamet Tartari për pasurinë dhe vlerat e saj artistike dhe estetike, si dhe vijën melodike të tyre është bërë objekt studimi i mjaft folkloristëve etnomuzikologëve, si: Çesk Zadeja, Beniamin Kruta, Feim Ibrahimi, Spiro Shituni, Limoz Dizdari, Kujtim Laro, Qemal Haxhihasani, Jorgo Panajoti, Ramazan Bogdani, Agron Xhagolli, Afërdita Onuzi etj. Kontributi i Muhamet Tartarit në zhvillimin dhe pasurimin e polifonisë shqiptare është një gur i çmuar që ka lënë gjurmët e veta në tërë etnokulturën e Labërisë.

PJESA E PARË

HAPA NË HISTORI

EPIKA POPULLORE MBI LUFTËRAT HEROIKE
TË SHQIPTARËVE - LIDHJA E PRIZRENIT
DHE PERIUDHA NË VIJIM

Kënga popullore e Labërisë, ashtu si tërë këngët popullore shqiptare janë një burim me vlera historike të popullit tonë. Me daltën e tij të mrekullueshme artisti popull i ka gdhendur me mjeshtëri këto këngë të bukura lapidare, duke u dhënë pavdekësinë sa e sa luftërave, sa e sa ngjarjeve dhe përpjekjeve për liri dhe pavarësi që ka bërë populli ynë ndër shekuj.

Shumë e vogël në sipërfaqe, por shumë e madhe në zemër dhe heroizëm është Shqipëria. Historia jonë është e shkruar me gjak trimash, histori luftërash dhe përpjekje të përgjakshme, që me mjeshtëri të rrallë artistike dhe me patos është pasqyruar në këngët e popullit.

Shkëmbinjtë e ashpër dhe gërxhet e thepisur të Labërisë janë dëshmitare të sa e sa betejave heroike, që janë zhvilluar mbas këtyre maleve, dhe nga gjokset e banorëve labë kanë buruar këngët: *O sulltan more sulltan / S'të japëm djemtë nizam / S'të japëm haraç e taksat / Hajde po ta mba pallaska / Të shoq djemtë e Shqipërisë / Ta japin plumbin në sisë...*

Populli ynë ka njohur gëzimin e madh të fitoreve mbi armikun, por ai ka njohur gjithashtu edhe mjerimin e disfatave, në të gjitha rrethanat ai ka qëndruar përherë i papërkulur dhe plot shpresë për të ardhmen. Këngët tona popullore i ka karakterizuar gjithmonë optimizmi dhe besimi në fitore; ato kanë fortësinë e maleve, pastërtinë e buronjave të borës, thellësinë e botës së pasur shpirtërore të popullit tonë artist, dhe mbajnë brenda madhështinë e heroizmit popullor.

Gjysma e dytë e shekullit të XIX është e mbushur me plot ngjarje të rëndësishme dhe jetike për fatet e popullit tonë, si 10 qershori i vitit 1978. Në këtë datë historike u mbledhën në Prizren përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe formuan lidhjen shqiptare që populli e ka quajtur Lidhja e Prizrenit. Ishte hera e parë që pas vdekjes së heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeut), që populli ynë do të mbledhej në një kuvend të përbashkët dhe që vendimet e rëndësishme që mori ky kuvend u kundërviheshin vendimeve famëkeqe të Fuqive të Mëdha të marra në Kongresin e Berlinit, si dhe qëllimeve të Portës së Lartë të Stambollit.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit, do t'i bënte pluhur e hi vendimet antishqiptare të kancelarive të mëdha të asaj kohe dhe do t'u jepte një grusht qëllimeve shoviniste dhe grabitqare të shteteve fqinje, si Serbia, Mali i Zi, Greqia, dhe Bullgaria që me tokat shqiptare kërkonin të kënaqnin orekset e tyre. Motivi i epikës historike gjatë kësaj kohe është lufta për jetë a vdekje për të mbrojtur me gjak viset shqiptare që ishin nxjerrë në pazar në Kongresin e Berlinit, duke hedhur poshtë thëniet e pathemelta të kancelarit Bismark se “Shqipëria është një shprehje gjeografike” dhe me ironi deklaronte se: “Barinj të injorantë të maleve të egra shqiptare na dashkan Shqipërinë”. Kënga e popullit me forcën që buronte nga zemra dhe thellësia e shpirtit shpërthen e fuqishme duke shprehur qartë betimin solemn të shqiptarëve se fatin e Shqipërisë e kanë në dorë dhe do e vendosin vetë shqiptarët: *S'jemi grekër as bullgarë as nga Mali i Zi / Jemi vetëm shqiptarë / Kërkojmë liri / Gra e burra do luftojmë / Sa të shuhemi...*

Shqipëria “një pëllëmbë”, ishte e detyruar t'u bënte ballë e vetme pa asnjë ndihmë, presionit të Fuqive të Mëdha, synimeve grabitqare ballkanike dhe presioneve të qeverisë së Stambollit të cilës ju ngarkua që të zbatonte vendimet e Kongresit. Prandaj qeveria turke dërgoi në Shqipëri forca ushtarake për ta detyruar popullin tonë që t'i dorëzojë Plavën dhe Gucinë Malit të Zi, dhe kur nuk ia arriti dot qëllimit që ta zbatojë këtë vendim, u urdhërua nga Fuqitë e

Mëdha që të dorëzohej Hoti dhe Gruda. Plavën dhe Gucinë, Hotin dhe Grudën e mbrojtën me gjak dhe heroizëm të pashoq jo vetëm banorët e këtyre krahinave, por e gjithë Shqipëria. Kënga popullore e Labërisë i ndien dhe i jeton nga afër këto ngjarje, pavarësisht se luftimet zhvilloheshin në veri: *Moj e shkreta Shqipëri / Ç'ta ngrenë vendin hasi / Sërbi edhe Mali i zi / U dhanë vulat në frëngji / Nëntë krale mbi Turqi...*

Por vendimet famëkeqe të Kongresit të Berlinit, i përflaku tyta e pushkëve dhe i dogji zjarri i barutit të trimave të lirisë, i trimave shqiptarë që për çdo gur e shkrepë të Atdheut “të merrnin gjak në vetull e në ballë”: *Gegëri e Toskëri / Muslimanë e të krishterë / Bëjën dyfek me sungji / Ç'u bë gjak, ç'u bë kërdi / Ra dovleti (shteti) në lloi...*

Lidhja e Prizrenit dhe vendimet e saj ishin bërë mish e gjak i mbarë popullit tonë. Në këtë kuvend programi i autonomisë gjeti mbështetjen e plotë. Udhëheqësi kryesor i Lidhjes është diplomati dhe politikani i shquar Abdyl Frashëri së bashku me kryetrimin Sulejman Vokshi. Sipas vendimeve të marra në kuvend, në çdo krahinë u krijuan degët e saj, e dega e Lidhjes në Vlorë kishte kryetar Mustafa Pashë Vlorën, një figurë historike të njohur edhe nga Porta e Lartë edhe nga Fuqitë e Mëdha.

Në korrik të vitit 1880, u bë një kuvend i Lidhjes Shqiptare në qytetin e Gjirokastrës ku morën pjesë përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Poeti popullor me mjaft bukuri e ka përjetësuar këtë ngjarje përmes vargjeve: *Kurvelesh dhe Gegëri / Ç'u mblodhën në Ergjëri / Lule Abdyl Frashëri / Luftove për Shqipëri...*

Këngët popullore të këtyre ngjarjeve ushtojnë në Kosovë dhe Labëri, në malësitë e Veriut dhe në Shqipërinë e Mesme. Nga zemra e maleve të Labërisë, nga Kuçi i trimave të Gjolekës, bënë jehonë vargjet e këngës për Abdyl Frashërin që i dërguar nga Lidhja e Prizrenit në vitin 1880, shkoi nëpër kancelaritë e Evropës si në Romë, Vjenë, Paris, Berlin për të mbrojtur ashtu si me pushkë edhe me diplomaci

të drejtat e shqiptarëve: *Abdyl prishe pasurinë / Një barrë flori / Vajte në Berlinë / Vajte të Bismarku brenda/ Ndënje në skamli...* Diplomati i shquar shqiptar me fjalët e tij si krisma betejash do t'ua bënte të qartë Fuqive të Mëdha, dëshirat dhe aspiratat e popullit tonë; ai do tu tregonte se kush ishte, nga vinte dhe ç'kërkonte: *Të pyenë edhe të thanë / Djalë nga je ti / Unë jam nga Shqipëria / Abdyl Frashëri / U lutem shikoni mirë / Ju për Shqipëri...*

Fjalët e Abdyl Frashërit në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, shprehën një të vërtetë të pamohueshme, se populli shqiptar s'kërkonte mëshirë, por të drejtat e tij legjitime: *Mos e bëni pjesë-pjesë / Sikur s'ka njeri...* Vetëm me dy vargjet e kursyera shpreh shumë poeti popullor, shpreh qartë se në Shqipëri ka vetëm një zot, dhe ky është populli shqiptar, “me hir, apo me pahir”, dëshirat dhe aspiratat e tij do të bëhen realitet se për këtë luftojnë dhe derdhin gjak shqiptarët.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit forcoi më shumë besimin se vetëm të bashkuar dhe nëpërmjet grykës së pushkës do të vinte dita e pavarësisë për popullin e shumë-vuajtur. Dhe kryengritjet pasuan njëra pas tjetrës nga Veriu në Jug Shqipëria ziente si një vullkan, kudo “lëvronte pushka e lirisë”. Një nga çetat kryengritëse në Labëri ishte edhe çeta e komitëve që populli i ka vënë emrin e komandantit të tyre Bilbil Shakos¹, duke e thirrur Çeta e Bilbilenjve.

Kjo çetë që bërë tmerr për pushtuesit turq, prandaj ata dërguan forca të mëdha për t'a shpartalluar atë, populli me dhimbje por në mënyrë krenare u këndon këtyre trimave: *Birbil Shako çepekrënde (flokë-ashpër) / Nga litari nuk u trëmbe / S'të erdh' keq për veten tënde..?! edhe pse pushtuesit otomanë i zunë bilbilenj të dhe i dënuan me varje në litar, atyre as ua bëri syri “tërr”, kur pashai turk urdhëronte: *Ngrehu Bilbil hidh litarë...* Bilbil Shekua me qetësinë e madhe, jo sikur shkonte drejt litarit, drejt vdekjes, por sikur për të ishte diçka e zakonshme përgjigjet: *Dale bej të pi cigarë/ Se s'jam çanaku me dhallë / Por jam Birbili me pallë...**

¹ Labët e përdorin këtë emër në variantin Birbil.

Ashtu si në tërë Shqipërinë edhe në trevën e Vlorës, trimëria dhe heroizmi nuk kanë munguar asnjëherë. Vetë kënga e popullit na i skalit figurat e atyre trimave e na duket se kurdoherë i kemi pranë duke na ngjallur admirim dhe respekt për veprat e tyre, se s'ka sesi të mos emocionohemi kur “ulemi për të pirë” me etje të madhe në gurrën e pashtershme popullore vargje të tillë: *Dërgon pashai fermanë / Mbi Tragjas e mbi Dukanë / Burra të ziri Lumanë...* Por trimat asnjëherë s'kapen gjallë e kështu nuk zihej dot as trimi tragjasiot Luman Bala dhe këtë e shprehën vetë pashallarët e xhandarët turq përmes fjalëve që aq natyrshëm kanë zënë vend në poezinë e popullit: *Dhe ta zëmë dot s'e mbamë / Si sorkadh e kapton malë / Na ther na grin me kamë / Na bën lakra me pallë...*

Kudo në çdo fshat në Vlorës, pushtuesit turq dhe shërbëtorët e tyre i priste plumbi i urrejtjes popullore, i digjte toka dhe i shkrumbonte guri, aty te “Rrapë tëndë”, si thotë kënga e popullit, në Sevaster: *Pleqtë ç'e lidhën kuvëndë / na kërkon Harizi gjënë (mallin)...* i ngarkuari i portës së lartë për të vjelë taksat dhe përgjigjen populli ja dha me plumb: *Ku ta gjejmë o Haris gjënë / E bëmë bukë e kemi ngrënë / U ngrit Osmëni në këmbë / Çkuli pisqollën ergjendë / Ja futi tymin në dhëmbë...*

Në çerekun e fundit të shekullit XIX qeveria turke i shtoi masat shtypëse ndaj shqiptarëve. Këngët e kësaj periudhe me nota të gjalla dhe realiste përshkruajnë disfatat e ushtrive turke në Shqipëri: *Turqit valë valë u derdhë / Vranë, prenë dhe shkretuan / Pesë pashallarë që erdhë / Që të gjithë u turpëruan.*

Populli ynë luftëtar dhe poet në sa e sa këngë të bukura ka ruajtur me besnikëri veprën e trimave të tij. Vargjet e këngës popullore vunjote na futin në ambientin e ngjarjeve të fshatit të tyre ku mulazimi detyroi një plak të këputur të paguajë taksat që s'ka se ku t'i gjejë: *Të shtunën gjashtë sahati / Mbikodhimë u bë fesati / U bë Bon Duk xhelati / Kush e njih Bon Cakuranë / Mbikodhimë e bë fesanë / Vrau mulazim beranë...* Këto ngjarje edhe pse të veçuara, shprehin qartë se mendimi i popullit tonë po piquej dhe po kristalizohej ndërgjegjja e qartë kombëtare. Fara “e mbjellë”

me aq kujdes nga rilindësit Abdyl, Naim e Sami Frashëri, Thimi Mitko, Zef Jubani, Kostandin Kristoforidhi, Hasan Tahsini etj, po “lulëzonte” në çdo skaj të Shqipërisë.

Në çdo krahinë po “gatuhej” dita e madhe e Pavarësisë, për të cilën s’do kurseheshin as mundi, as sakrificat, as gjaku i kulluar i bijve trima të Shqipërisë. Vitet e fundit të shekullit të XIX, që regjistronte kalendari pas Lidhjes së Prizrenit janë dëshmi e qartë e stuhive kryengritëse sa në veri edhe në jug. Porta e Lartë e Stambollit po dërgonte njëra pas tjetrës ekspeditat e saj ndëshkimore, duke ua besuar komandën pashallarëve të saj më të zotë: *Gjeneral spaletan-grirë / Shumë ngjake me vezirë / Por siç duket s’e di mirë / Sa sulltanë e sa vezirë / Këto vende kanë grirë...*

Malet dhe gërxhet shqiptare s’pyesin për ushtritë e mëdha turke as për armët e panumërta të tyre, as për titujt dhe gradat e komandantëve osmanë, të cilët shprehnin habinë e tyre përmes fjalëve që poeti popullor i ka rimuar aq bukur : *S’kemi parë këshish mileti / Sojë asllani xhet pas xheti / Nuk bëjnë ç’u thotë dovleti / Ky millet e ky llaus / Edhe vdekjen e përbuz...*

Këngëtarët dhe rapsodët popullorë, duke shprehur ndjenjat dhe aspiratat e popullit, kanë nxjerrë në dritë lidhjet mes feudalëve drejtues me perandorinë: *Pa dëgjo o beu ynë / Mbaje mirë terezinë / Se njerëzia u piknë / E pe Abdul Bej Selimnë / Kullat e bardha në brinjë / Kukumjaçkat ulurijnë / Ashtu do t’i lësh edhe tinë...*

Shtypja e egër ekonomike, detyronte popullin tonë të ngrihej në luftë gjithmonë për të kërkuar të drejtat ekonomike dhe politike, lirinë e fjalës dhe shkrimt shqip. Gurra popullore gjithmonë e pashtershme, gjithmonë e freskëti këndoi dhe e përjetoi heroizmin popullor të këtyre viteve. Në vargjet e këngëve ndihet një lëvizje e madhe; ngjarjet që përshkruhen nuk kanë karakter krahinor e lokal, por kombëtar: *Do ngrihemi të tërë / Turku të na lërë vëndë / Jemi zot për Shqipëri...*

Vitet e para të shekullit të XX ishin vazhdim i ngjarjeve pas Lidhjes së Prizrenit. Këto vite regjistroheshin të shoqëruara me dallgët e mëdha kryengritëse në të katër anët e Shqipërisë, për të

nxjerrë përtej brigjeve të atdheut “të sëmurin ë Bosforit”. Poetët popullorë në vargjet e tyre të kursyera si fishekët e kursyer, godasin përherë në shenjë: *Pritna o qeni turkoshak / Ymrin e ke me sahat / Kocka s’do të gjejë rehat...*

Lufta heroike e popullit tonë, po e afronte ditën e shpalljes së pavarësisë, atë ditë që për pesë shekuj me radhë ishte ëndërruar dhe kërkuar me gjak të kulluar shqiptari. Vitet 1909-1912 shënojnë “epilogun” e luftërave antiturke. Në këto vite shpaloset madhështia, heroizmi i trimave të Çerçiz Topullit e Mihal Gramenos që aq bukur është përjetësuar në vargjet e luftëtarit të kësaj çete, trimit kuçjot Sino Xhelit: *Te rrapi në Mashkullorë / Foli Çerçizi me gojë / Mulazim largo taborrë / Se të kuq të bëj me bojë / Çerçiz Topulli më thonë...* Po kështu shpaloset heroizmi dhe trimëria e Ded Gjon Lulit, Isa Boletinit, Hasan Prishtinës e Bajram Currit, shpaloset vepra e pavdekshme e plakut të Vlorës, patriotit Ismail Qemali: *Më 28 nëntor / Më këmbë u ngrit Shqipëria / Smail Qemali në Vlorë / Bashkë me shokët e tija / Ç’i tha popullit me gojë / Poshtë o shokë robëria / Evropa le ta dëgjoja / Nuk ka vend këtu Turqia / Ja të vdesim ja të rrojmë / Është e jona Shqipëria....*

Tiranë, më 10 qershor 1978

LUFTA E VLORËS NË KËNGËN TONË POPULLORE¹

Kënga jonë popullore ka fiksuar me vërtetësi historike gjer në saktësinë e informacionit kronikal, me bukuri poetike dhe ngjyrim popullor të një figuracioni të rrallë Epopenë e Lavdishme të Njëzetës sintetizuar bukur në vargjet: *Ja do bëhet Vlora jonë / Ja do bëhet shkrumb e hi...* Të këtij brumi, dhe të kësaj bukurie, këngët e shumta popullore kushtuar Epopesë së Njëzetës, zënë vendin e tyre të rëndësishëm në epikën popullore historike. Ato i përshkruajnë ngjarjet e kësaj lufte të lavdishme popullore në mënyrë të hollësishme, duke filluar që nga vendet ku u zhvilluan kuvendet, betejat, datat, pjesëmarrësit, rezultatet, llojet e armëve që u përdorën, të rënë, të plagosurit, robërit, jeta dhe psikologjia e tyre.

Heroizmi popullor, shpaloset me madhështi përmes vargjeve, strofave, këngëve. Jehona e kësaj lufte, thirrjet kushtrim të luftëtarëve popullorë, bujqve dhe çobanëve, zjarri i pashuar i dyfekëve me gjalmë, i fishekëve që hynin në folenë e pushkës së bashku me thërrimet e bukës së misrit, krismat e tyre të sarta, hedhja legjendare e gunave mbi tela e i gjokseve mbi istikame, drita e kuqe e pashuar e plagëve në gjoksin e luftëtarëve të lirisë, për këto mrekulli të shqiptarëve: *Evropa shkruajnë e thonë / Ç'është kështu si dëgjojmë / Bëhet dyfek në Vlorë...*

Gjithë këtë habi të shteteve dhe Fuqive të Mëdha në Evropë, poeti popullor e shpreh në mënyrë sugjestive e me vargje lakonike: *Shqipëtarët po luftojnë/ Me një mbret 40 milionë...* mendime këto

¹ Kumtesë e mbajtur në simpoziumin shkencor organizuar nga Instituti i Historisë, Tiranë dhe Muzeu Historik i Vlorës.

me një rezonancë kuptimplote me historinë e popullit tonë. Përsëri me mjaft forcë shprehëse, me skalitje mjeshtërore, që vetëm dalta e artistëve popullorë ka mprehtësinë të gdhendë, këndohet: *Po me se luftojnë vallë? / Me sopata me hanxharë/ Dyfekët lidhur me gjalmë/ Fishekët në xhep i mbajnë/Në tre ditë bukë hanë...*

Këngët dhe vallet kushtuar kësaj epopeje të lavdishme, janë të panumërta, njëra më e bukur se tjetra, me një kënd të gjerë shikimi dhe hapësirë vendi dhe kohe. Edhe pse në këtë punim jemi përqendruar vetëm te disa këngë, veçanërisht të Lumit të Vlorës, ato na flasin për Barçallanë e Beunin, për Gjormin dhe Kotën, për Drashovicën dhe Llogaranë. Gjeografia poetike e tyre shkon edhe në Tepelenë dhe Mallakastër, në Korçë dhe Myzeqe, në Gjirokastër e Gegëri e deri jashtë kufijve të Atdheut, ku ka shkuar zëri i kësaj lufte, aty e ka ndjekur edhe kënga. Kjo tregon një fakt të pamohueshëm, syri i këngës popullore, duke qëndruar mbi majat e larta epike të ngjarjeve ka një horizont të madh shikimi, me një fuqi të madhe drite.

Është fakt historik, se midis luftëtarëve pjesëmarrës në këtë luftë kanë qenë dhe rapsodët e dëgjuar popullorë, si: Selim Hasani (Artist i Popullit), Xhemil Duka, Mato Hasani etj. që sot kur lexojmë vargjet, apo këndojmë këngët e tyre, herë-herë na duket se pas tyre dëgjojmë krismat e armëve që shkrepën me bashkëluftëtarët, britma e luanëve tek shtrojnë shirqet mbi tela dhe istikame, tek hidhen në sulmet e furishme. Këto vargje, e këngë mbartin në vetvete ngarkesa të mëdha ideo-emocionale, përmes të cilave, ndjejmë gëzim dhe trimëri njëherësh, dhimbje për të rënë, por krenari për veprën e tyre heroike, për mbrojtjen me gjak të çdo pëllëmbë të tokës amtare.

Në këtë punim, duke iu drejtuar një pjese të këngëve popullore, të mbledhura ndër vite, njihemi me ato ngjarje të rëndësishme të cilat zënë një periudhë kohore prej më shumë se tre muajsh, nga 29 maji deri më 3 shtator, dhe që janë regjistruar në Historinë e Shqipërisë si “epopeja e Luftës së Vlorës më 20-ën”.

Themi fillimi më 29 maj, se kjo Luftë kishte kohë që gatuhej. Brumi kishte ardhur gradualisht duke u pjekur, eshka kërkonte çikat e stërrallit që të ndizej flakë! Këtë, siç dihet e bëri Kuvendi i Barçallasë, ku morën pjesë mbi 300 përfaqësues nga të gjithë fshatrat e krahinat: *Maji më 29-të / Barçalla në mal të Shënjtë / Ngre plan populli vetë / Të vdesim për Atdhen 'e shtrenjtë...* Atje u vendos prerë që t'i shpallet luftë Italisë, të goditet ajo deri në fund, pa marrë parasysh asnjë sakrificë deri në çlirimin e Vlorës dhe bashkimin me pjesën tjetër të Atdheut. Për vendimet e Barçallasë, thotë kënga: *Fshat më fshat kartat u ndanë / Vunë çetat kumandarë / Salari Selam Musanë/ Në Vranisht Sali Muranë...* dhe kënga vazhdon vargjet gur-gur e rrit murin e epopesë së këngës, si kroniste e saktë të tregojë se si çdo fshat ngriti çetë dhe: *Të gjithë një fjalë thanë / Erdhëm dhe do derdhëm gjaknë...*

Kënga regjistron ngjarjet, faktet dhe datat. Pas Kuvendit të Barçallasë nuk kaluan veç dy-tre ditë, dhe vargu i këngës ndjek për gjurme tërë atë masë të madhe luftëtarësh nga të gjitha anët që derdhen në fushën e luftës, si në stofin e këngës: *Në Beun kur u mblodhë / Dymbëdhjetë komisjonë...* Që aty, ju dërgua dhe Ultimatumit Gjeneral Piaçentinit në Vlorë me ato fjalë të prera me urdhër me strallin e gjuhës së maleve tona: “Popullit Vlorës kërkon heqjen e ushtrisë italiane dhe bashkimin me Tiranën, ndryshe me armë në dorë do të rebelohet. Në mos mundtë, do të vdesë për liri...” dhe korrieri i Ultimatumit merr letrën, nisat vetëtimë për në Vlorë: *Mehmet Selimi dragoi / Mori kartën edhe shkoi / Komandës ja dorëzoi...* Vargje këto, të qeta në madhështinë e tyre, aq sa edhe të patundura në vendimin e dhënë.

Krijimtaria e bollshme gojore e popullit na përshkruan më tej shtjellimin e ngjarjeve, përgjigjen negative të komandës italiane, si dhe gatishmërinë e luftëtarëve për të nisur sulmin sa më parë: *O ju djem trima stralli / Na thërret Smail Qemali / Atje ku dergjet te varri...* Te historia me luftë ecën populli, me këngë në çdo hap të ngjarjeve, duke mbajtur mbi supë amanetin e të parëve, siç është

kujtimi i afërt i Ismail Qemalit. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare ndau çetat dhe detyrat e sulmit në Gjorm dhe Kotë, në Tepelenë dhe Llogara, në Drashovicë dhe Jonufër. Sulmi i mesnatës së 5 Qershorit në të gjithë frontet, i befasoi dhe tronditi forcat italiane. Rrebeshi i forcave kryengritëse ishte i pandalshëm si vërshimi i ortekëve: Ç'u derdhën labët në brinja/ Pritna breshka qëne pritna/ Ju hodhën si vetëtima...

Mbas luftimesh të ashpra, filluan të binin në duart e kryengritësve një nga një garnizonet më parë në Gjorm e Tepelenë. Dhe kënga e popullit regjistronte, për t'ua përcjellë brezave bukurinë e asaj lufte: *Telat po venë e vinë / Kërkon Goti Piacentinë / Qysh do bëjmë unë e tinë / Se shqiptarët errinë / Gjorm janë e poshtë po vinë...* Po këtë bisedim telefonik e lanë të papërfunduar forcat e luftëtarëve të Shullërit të prira nga trimi smokthiniot Zigur Lelo: *Obobo se ç'qenkej Kota / Më e bukur se Evropa / Bytym mitraliozë e topa...* Por vrulli i kryengritjes popullore nuk pyeste për topa dhe mortaja, për tela dhe për istikame. Asnjë pengesë nuk e ndalte shpërthimin e kryengritjes popullore, as ushtritë e panumërta, as armatimet moderne, asnjë nuk i bënte ballë forcës së pakufishme të dashurisë për atdheun e lirinë të bëra një me trimërinë dhe guximin, me mprehtësinë dhe zgjuarsinë, me besën dhe burrërinë shqiptare. Garnizonii Kotës bie në duart e forcave kryengritëse dhe gjeneral Goti u vra: *Në Kotë komita kur ra / U vra Ziguri në portë / U vra Zigur Lelua...* Ra heroikisht ashtu si ishin vrarë dhe i gjyshi dhe i ati në luftë kundër pushtuesve osmanë; ai u vra për Vlorën e lirë, për tërë Nënë Shqipëri, me fjalët në gojë: *Burra djemt'e Smokthiniot / O burra trima mbi ta.* Ky është heroizmi shqiptar, që nuk pyet për therorinë e vetë, por vetëm të arrihet qëllimi, çlirimi i tokës nënë.

Këtë heroizëm masiv popullor të kësaj lufte, kënga na e përshkruan me figura të fuqishme poetike, duke portretizuar me saktësi dhe me plot dritë trimërinë e luftëtarëve që sulmojnë pa ju trembur syri e pa iu dridhur dora, që hidhen me guxim të pashoq

mbi llogoret e armikut, duke u përleshur trup më trup me pushtuesit e mëmëdheut se ata janë bij të denjë të Nënës Shqipëri, të nënave të lavdishme shqiptare: Ç'paskan pjellë ato nëna / Paskan pjellë e bërë drera / Luftojnë e s'u tundet këmba...

Këto këngë nuk janë thjesht kronika ngjarjesh, ato shprehin karakterin sa heroik, aq edhe popullor të luftës. Ato bëjnë me mjeshtëri të veçantë përgjithësime të heroizimit masiv, dhe virtyteve të larta të popullit tonë të farkëtuara këto nëpër luftëra të përgjakshme për lirinë, pavarësinë dhe drejtësinë shoqërore. Këto këngë, duke pasur si shtrat lindjeje flakën e betejave kundër zaptuesve, duke u ushqyer me heroizmin e luftëtarëve buzë llogoreve, pranë bijve që derdhën gjak për mëmëdheun, duke fotografuar tmerrin, panikun, si dhe vrapin e armikut për tu mbyllur në Vlorë, na sjellin me madhështi dhe plot emocion gjithë atmosferën heroike të kësaj lufte: *Flaka, tymi, zëri i këngës / Lot (lëviz) foshnja në bark të nënës / Luftë e racës arbëreshe / Llogoret i berë sheshe...*

Këngët popullore kushtuar Epopesë së Njëzetës në tërësinë e tyre janë një lëndinë në valët e maleve tona, plot më lule shumëngjyrëshe. Ato të gjitha kanë karakteristika të veçanta por edhe të përbashkëta që nuk mund t'i ndash. A ka përshkrim më të bukur dhe më të goditur se për trimin që edhe pse i gjymtuar nuk largohet nga fronti, por qëndron dhe lufton me guxim dhe trimëri të pashoqe, ai nuk tërhiqet nga beteja, se akoma i rreh zemra, i sheh syri dhe i punon gishtin. Ai mposht edhe vdekjen: *Kanan Mazja nga Shkoza / Me një nofull copa-copa...* Vetëm heroizmi shqiptar i përshkruar sa me vërtetësi aq edhe me solemnitë në këngët e popullit, tregon për këto trimëri të pashembullta: *Kanan t'u prish bukuria / Le të rrojë Shqipëria / Shqipëria le të rrojë / Ç'ka se mbeta unë pa gojë...*

Përmendim një këngë tjetër popullore, me bukurinë e asaj epopeje: *Në Sherishta m'u te fiku / Ku bëri yxhym armiku / Bëri se ashtu i thanë / Shqipëtarët aty s'janë / Vanë të falën bajramnë...* Poeti popullor, zëdhënës i psikologjisë dhe heroizmit në tërësi

të popullit tonë, në këtë këngë e sheh Epopenë e Vlorës nga një këndvështrim i veçantë, me vëmendje dhe admirim. Këtë veti, edhe luftëtarët e Vlorës siç e thotë edhe kënga, e ngritën në një shkallë më të lartë.

Nga gurra e pashtershme e krijimtarisë gojore të popullit burojnë vargje që i kushtohet një prej figurave më të shquara të kësaj epopeje, trimit të trimave, Selam Musa Salarisë, luanit që zuri topin nga gryka, dhe mbeti i pavdekshëm me shikimin drejtuar mbi detin: *Të vranë o Selam të vranë/ Në Babicë përmbi hapsanë/ Në qafën që sheh limanë...* Vargjet e këngëve kushtuar Selam Musait, si një simboli të madh të pavdekshëm, janë të shumta, se me përmasa të mëdha është vepra dhe bëma e tij, është heroizmi i shpalosur në luftë dhe i derdhur në këngë, se trimat i duan dhe i nderojnë trimat. Dihet, po qe se kërkon të njihesh sa më mirë me figurat e luftëtarëve popullorë, njihi me këngët që janë ngritur për ta, se populli me vargjet e tij nuk u ka lënë asnjë mangët pa ua thënë e pa ua bërë në mënyrë të hollësishme biografinë e tyre. E kështu ndodh edhe me Heroin, Selam Musa Salarinë, që erdhi pa filluar sulmi me 100 e ca djem nga Tepelena, trima me fletë të sprovuar në betejat me andartët shovinistë grekë në vitet 1914-1916, ku trimëria dhe pushka ua ka zbardhur faqen e po kështu edhe në këtë luftë ua zbardhi përsëri: *Ç'u dha komandën Selami / O djem se iku vatani / Vlorënë me gjak ta lani...*

Heroizimi i Luftës së Vlorës është masiv. Në këtë Epope spikat edhe pjesëmarrja e grave, ndihma e pakursyer e tyre. Kur u plagos rëndë luftëtari vranishnjot Sali Shkurti, e ëma e tij me kurajë dhe trimëri të pashoqe, zorrët e të birit që i dilnin jashtë, ja lan nga pluhuri e baruti dhe ja shpie sërish në vend. Gruaja në këtë luftë luajti një rol të madh si në vijën e parë të sulmit, si Sado Koshena me shoqe, po ashtu edhe në prapavijë që aq bukur e jep kënga: *Eni shoqe t'u ndihmojmë/ Vëllezërve që luftojnë/ Tu shpiem bukë e fishekë / T'u hapën nga një hendek...* Kur i pa edhe gratë me pushkë në krah, agjenti italian Ulise Bozo, që ishte dërguar nga komanda

italiane për bisedime me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare në Drashovicë, iku i tmerruar në Vlorë duke ua përcjellë të saktë moralin e lartë të kryengritësve, gatishmërinë e tyre për të luftuar deri në çlirimin e plotë të Vlorës. Ja sa bukur e ka futur populli në këngën e tij, thënien e agjentit padronëve: *Erdhi Bozua e thotë / Habere të mira s'ka/ O Mbret qysh do bëjmë na / Albania është e fortë / Luftojnë burra edhe gra...*

Rënia në duart e kryengritësve e të gjitha garnizoneve, si dhe rrethimi në një darë të hekurt të forcave italiane brenda në qytetin e Vlorës e tërboi Gjeneral Piaçentinin. Ai nuk e kishte menduar dhe nuk donte ta pranonte këtë disfatë, por realiteti fliste kundër tij. Shpartallimi i plotë i ushtrisë italiane dhe fundi pa lavdi i gjeneralit, i cili kërkonte të ndryshonte gjendjen: *Gjenerali në Pallat/ Fryhej e desh të kesh plasë/ Hëngri kokrrën e zhivasë (helmit)/ Dërgoi për fluturaks (aeroplan)....* Por, as shantazhet e as dredhitë, as lajkat e as bombardimet e topave e avionëve nuk do i thyenin dot dallgët e kryengritjes popullore, vrullin e pandalshëm të luftëtarëve. Pushka me gjalmë mori garnizone e kala, vulosi topa e shoi “alitrika”, gremisi aeroplanë: *Në fushë të Peshkëpisë / Aeroplani i Italisë/ U këput e ra si mizë...*

Kënga e popullit ka regjistruar dhe i bën “apelin” njërit prej luftëtarëve më të shquar të kësaj lufte, jo vetëm për Vlorën por edhe Tepelenën e Gjirokastrën. Fjala e tij ngrinte peshë zemrat e fshatarëve dhe punëtorëve të popullit fukara, ndaj kënga flet: *Të kish rritur Labëria / Djalëi popullit Halim/ Halim Xhelo trim o trim...* Se Halimi ishte bir i rrallë i popullit, se jetoi mes popullit, se e desh atë, se luftoi dhe u sakrifikua për popullin dhe Atdheun, ndaj mbeti i pavdekshëm: *Halim Xhelua djalë i shquar/ Malit me Flamur në duar/ Populli nga pas çë muarr/ Ishin trima të kulluar...*

Pikaku kishte mbështetur shpresat e fundit komanda italiane, ishte Kalaja e Kaninës. Për marrjen e saj nga ana e forcave kryengritëse u ngarkuan nga Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare çetat e Rrëzës, dhe ajo e Kaninës nën komandën e Sali Vranishtit dhe Beqir Velos.

*Çet'e Rrëzës u vërvinë / Majës së Vreshtave rënë/ Kapedan kishin Salinë / Trimn e madh zemërçelikinë... Luftime të ashpra u zhvilluan për marrjen e kalasë. Këtu shkëlqeu edhe njëherë me madhështi heroizmi i luftëtarëve kryengritës, guximi dhe trimëria, vetëmohimi dhe shpirti i lartë i sakrificës, qëndrueshmëria dhe gjakftohtësia, shkathtësia dhe zgjuarsia, burrëria dhe papërkulshmëria. Ja si e ka përshkruar poeti popullor plagosjen rëndë të Kapedan Sali Vranishtit dhe përgjigjen e tij: *Bombat dhe gjylet e grinë / Tha: në tel çorra kërcinë / Të mos helmon shoqërinë...**

Përballë këtij heroizmi dhe garnizoni i fortifikuar më së miri i Kalasë së Kaninës ra në duart e luftëtarëve popullorë. Rruga për në Vlorë u hap, forcat pushtuese pranuan humbjen dhe filluan tërheqjen me turp për në vendin e tyre. Kjo u arrit me luftë e më gjak, me trimëri dhe heroizëm, me guxim dhe burrëri. Luftuan rreth 4000 luftëtarë, prej të cilëve 2000 ishin vlonjatë, dhe 2000 ishin tepelenas, gjirokastritë, mallakastriotë, elbasanas, korçarë, malësorë etj. Ranë në fushën e nderit mbi 400 dëshmorë.

Data 3 shtator 1920, ishte ditë feste dhe hareje. Luftëtarët hyjnë në Vlorën e lirë fitimtarë, me flamur e pushkë në dorë e me këngë në gojë: *Nuk e bëjmë kabull na / Të jemi për nën botë/ Aferim o fukara / Që u vratë e u plagostë...* Dhe vargu i këngëve, i valleve zgjatej e zgjatej pa mbarim, se i pakufishëm ishte gëzimi i fitores. Populli ynë ka shpirt dhe zemër të madhe. Ai urren dhe lufton fuqishëm çdo armik, pushtues e tradhtar e po aq fuqishëm dashuron e flijohet për tokën, për Atdheun e vet, për lirinë e Shqipërisë, për shokun dhe mikun e besës. Ndaj i kemi të paharruara këngët e atij 3 shtatori edhe sot: *Rrofsh moj rrofsh moj Shqipëri / Rrofsh moj Korçë e Gegëri/ Lumthi ti moj Toskëri / Vlorë e bëri beli...*

Në konkluzion të këtij punimi, mund të themi se kënga jonë popullore për epopenë e Vlorës ka si veçori:

Së pari: Pasqyrimi flakë për flakë dhe i menjëhershëm i ngjarjeve në këngë, kjo edhe për faktin se si luftë popullore, kjo epike,

popullin e pati edhe si luftëtar, edhe si këngëtar. Ata vetë krijuan, vetë i kënduan poezitë, para dhe pas betejës.

Së dyti: Kjo krijimtari e gjerë dhe e pranishme kudo si blerim në relievin e vendit, ka saktësinë e çuditshme të informacionit, ku vargu poetik është edhe dokumentacion arkivor për ngjarje, data, vende dhe njerëz.

Së treti: Kjo epikë popullore, duke kënduar majat e ngjarjeve dhe të heronjve me dritën me të fuqishme, ka një shtrirje të gjerë në përshkrimin e luftës popullore masive, duke e harmonizuar këtë me përshkrimin e heronjve dhe ngjarjeve më sublime.

Së katërti: Këngët e kësaj epopeje duke qenë sintetike e të kursyera në vargje, kanë densitet mendimi, me një figuracion që shpesh të befason.

Së pesti: Ndonëse ato kanë një thjeshtësi dhe qartësi të veçantë, ku e bukura dhe poetikja, kënga i përçon gjithandej dhe lehtësisht mesazhet dhe mendimet, nëpër transparencën e thjeshtësisë dhe qartësisë.

Për Luftën e Vlorës, ashtu si për çdo ngjarje të historisë sonë, kënga ka vlerë të madhe dhe të përhershme dhe të pazëvendësueshme për kohën dhe brezat, për lexuesit dhe për krijuesit e arteve tona, dhe për mbarë popullin shqiptar.

Vlorë, më 2 qershor 1980

LUFTA E FSHATARËSISË SË VLORËS KUNDËR SUNDIMIT OSMAN GJATË PERIU DHËS SË RILINDJES

Si i gjithë populli shqiptar, edhe fshatarësia e krahinës së Labërisë ka të kaluarën e vetë të lavdishme, të shkruar me majën e shpatës e të jataganit, me grykën e pushkës, kundër pushtuesve të huaj. Të përgjakshme kanë qenë luftërat e shqiptarëve, zhvilluar gjatë shekujve. Në damarët e historisë sonë rrjedh edhe gjaku i kryengritjeve të fshatarësisë së Vlorës, kundër sundimit osman. Mbas vdekjes së heroit kombëtar, Skënderbeut, bisha e Anadollit, ushtritë osmane u derdhën mbi truallin shqiptar, për ta zaptuar, por shqiptarët as nuk i nënshtroi e as i mposhti dot.

Labëria, Mirëdita, Dukagjini, Çermenika gjithë malësitë shqiptare, nuk i lëshuan armët, nuk i zbatuan urdhrat dhe dëshirat e Portës së Lartë të Stambollit. Me qindra pashallarë, serasqerë, gjeneralë, udhëheqës e strategë ushtarakë turq, me mijëra ushtarë me sulltanë në krye, nuk mundën dot t'i nënshtrojnë këto krahina. As me hekur e me zjarr, as me dhëlpëri e para, asnjë nuk kishte vlerë në gërxhet dhe shkrepat e Shqipërisë, ku gjëja më e çmuar ishte liria.

Me fillimin e shekullin të XIX, Perandoria Osmane, sistemi feudal ushtarak i saj, filloi të tronditej thellë. Klasa sunduese otomane, nga ana e saj, për të nxjerrë Turqinë nga kjo gjendje, ndërmori një varg reformash centralizuese me karakter ushtarak, ekonomik dhe administrativ. Kulmi i reformave centralizuese osmane, në periudhën e parë, arriti më 1839, kur sulltani Abdyl Mexhiti shpalli fermanin “Hatti Sherif i Gulhanes”, që u quajtën

reformat e Tanzimatit¹. Reformat e reja, vendosi Porta e Lartë, të zbatoheshin në të gjithë territorin e Perandorisë, edhe në ato krahina që kishin qenë gjysmë autonome. Taksat e shumta që vendosi porta e lartë si dhe ligji për nizamin, (shërbimi i detyrueshëm ushtarak që do të zgjatë pesë vjet si rekrut, dhe shtatë si rezervë të cilën shqiptarët do ta kryenin në viset më të largëta të perandorisë) e rënduan jetën e vendit.

Perandoria turke, nuk i zbatoi menjëherë këto ligje në Shqipëri, por mbas 6-7 vitesh. Aty rreth vitin 1846, këto reforma, populli shqiptar i priti me armë kryengritjeje. Një nga kryengritjet më të mëdha të kësaj kohe është, Kryengritja e Shqipërisë së Jugut, e vitit 1847. Udhëheqësit e fshatarësisë, Zenel Gjoleka, Çelo Picari, Rrapo Hekali, Hodo Nivica, Hadër Sulo Kanina, Dervish Ali Dukati, Mete Çobo Vranishti, Lulo Abazi e Beqir Selimi nga Tërbaçi, lëshuan kushtrimin: “O burrani më këmbë, ngjishni armët kundër pushtuesit”. “Besëlidhja shqiptare”, e quajtur nga të huajt: “Lidhja e Fuqishme Shqiptare” e referuar qysh më nëntor të 1828-ës, filloi të fuqizohej përsëri. Më 1846 u organizua më mirë dhe nga “Besëlidhja Shqiptare”, doli “Komiteti Kombëtar i Kryengritjes”.

Krerët e fshatarësisë nga të gjithë fshatrat e Labërisë, Kurveleshit, Bregdetit, që nga Mallakstra e deri në Prevezë, u mbledhën në Kongresin e zhvilluar në fshatin Picar të Kurveleshit, në vendlindjen e birit të shquar të këtij fshati, Çelo Picari. Sipas të dhënave të historianëve europianë, kongresi zgjodhi udhëheqësit e Kryengritjes të cilët ishin të gjithë fshatarë të varfër, por të pasur në trimëri. Besëlidhja e mbledhur në Picar, mori këto vendime:

1. Populli shqiptar, myslimanë e të krishterë janë një e të pandarë.
2. Besëlidhja u siguron nderin, jetën, pasurinë, gjithë shqiptarëve, pavarësisht nga feja.

¹ Fjala *tanzimat* në gjuhën turke vjen nga rrënja “tanzim”, që do të thotë të mbledhësh, të grumbullosh.

3. Shqiptarët pa përjashtim, myslimanë e të krishterë, në luftë kundër Turqisë.

4. Me luftë të hapur, ta detyrojmë qeverinë turke, të heqë këto reforma të reja, që e skllavëronin popullin shqiptar.

5. Të kufizohen garnizohen turke në Shqipëri.

6. Besëlidhja caktoi numrin e luftëtarëve që do të jepte çdo krahinë.

Për sa i përket luftëtarëve të saj, nxori këto urdhra:

1. T'i shmangen dhunës dhe hakmarrjes.

2. Të mos lindin armiqësi.

3. Të mos i bien më qafë popullsisë.

Sipas historianit grek Arvantinoi, në maj të vitit 1847, shpërtheu kryengritja e Shqipërisë së jugut, që po ziente prej kohësh, më e fuqishme nga çdo kryengritje tjetër që nxori ky vend. Pothuaj të gjithë shqiptarët pa përjashtim, të pakënaqur nga shërbimi i detyrueshëm ushtarak, nga taksat e rënda, erdhën në marrëveshje dhe u betuan që me një kundërshtim të fortë dhe të përgjithshëm ta detyrojnë qeverinë turke, të ndalojë zbatimin e reformave të reja (Tanzimatin).

Në qershor të 1847, krerët e Besëlidhjes menduan dhe panë të arsyeshme të zhvillojnë një tjetër takim të përbashkët të tyre. Ky takim u zhvillua në fshatin Mesaplik të Smokthinës dhe populli e përjetësoi këtë mbledhje në këngën e tij: *Mesaplik të rrapi i thatë / Për një ditë e për një natë / ç'u mblodhën gjithë kazatë...* Në përfundim të këtij kuvendi u vendos dhe iu dërgua sulltanit në Stamboll, serasqerit (komandanti ushtarak) të Rumelisë dhe valiut (prefektit) të Janinës ku mes të tjerave thuhej: “Jemi kundër Tanzimatit”, “nuk i japim ushtarë qeverisë turke”, “të hiqet administrata e re osmane në vendin tonë”, “të dënohen rreptësisht të gjithë shkaktarët kryesorë të këtyre trazirave që u bënë në popull dhe që shkaktuan kaq dhunime dhe padrejtësira të mëdha” etj.

Besëlidhja mori edhe këto vendime për forcimin e disiplinës në radhët e luftëtarëve të saj:

1. Të mos bëjnë as dëmtimin më të vogël në popullsinë vendase.

2. Ushqimet e luftëtarëve sa të ishte e mundur të siguroheshin nga e dhjeta e bereqetit e cila ishte taksë e vjetër (ose nga çdo taksë tjetër e vjetër), dhe për tërheqjen e tyre komandanti i krahinës duhet të lëshonte një dëftesë të firmosur.

Forcat kryengritëse të kazasë së Vlorës, me në krye udhëheqësit tyre, Hadër Sulo, Beqir Velo Kanina, Dervish Aliu, Elmaz Rodaku nga Dukati, Mete Çobo Vranishti, Hito Daut Mavrova, Haxhi Hoxhë Smokthina, Lulo Abazi dhe Beqir Selimi nga Tërbaçi, u takuan me Rrapo Hekalin dhe forcat kryengritëse të Mallakastrës në Povël dhe që andej u nisën në drejtim të Greshicës, ku gjendeshin forcat e Hysen Pashë Vrionit. Populli këndoi: *Doli Rrapua në Sinjë / Seç e mblodhi miqësinë / Dil o Lumë i Vlorës-o / Dil se do të dalim-o / Të mëdhenj të vegjël-o / Kemi hall me Vrion-o...*

Greshiciotët trima, luftuan heroikisht vetëm për një natë e për një ditë, duke kthyer edhe gurët e mullinjve në barrikadë, derisa mbërritën nga jug-perëndimi forcat kryengritëse të Lumit të Vlorës nën komandën e Haxhi Hoxhës, Dule Zotos dhe Tartar Memushit nga Smokthina, dhe të Hadër Sulos nga Kanina. Luftë e përgjakshme u zhvillua në kodrën e Ferobeajit: *Moj Greshica maja maja / Për të tre ditë u bë hataja...* Pas një beteje shumë të rreptë, trup më trup, kodra ra në duart e kryengritësve të Lumit të Vlorës. Dëmet e armikut ishin të panumërta, por edhe të luftëtarëve vlonjatë nuk ishin të pakta: *O ju gratë e greshiciote / Qani djemtë e smokthinjote ...*

Morali i kryengritësve, ishte shumë i lartë ndërsa forcat turke, luftonin të dëshpëruara për jetë a vdekje, duke filluar të tërhiqeshin, kurse trimat kryengritës të revoltuar nga humbjet e pësuarat, u betuan për një të vrasim njëzetë. Ata lanë pushkët dhe përvishen trup më trup me pallë në dorë, përleshja zhvillohet në lagjen Muçaj, por forcat kryengritëse i detyruan pushtuesit të dorëzohen: *Dy qind e tridhjetë me radhë / I shkuan gjithë në pallë / Tartar Memushi nga*

Vlora/ Preu sa i deshi dora... Kryengritësit vlonjatë krah për krah me vëllezërit e tyre mallakastriotë treguan trimëri të rrallë në këto luftime: Tragjas e Dukati shumë/ Dil o Kanina me vulë / Kaza e Vlorës furtunë / Asnjëri nuk u përgjunjë...

Sulltani dërgoi ushtri të shumta për të shtypur këtë kryengritje, nga ana e detit ushtrinë turke, zbarkuan në Vlorë dhe Himarë dhe u bashkuan me forcat e tjera të shumta të serasqerit të Rumelisë. Hordhitë e panumërta, nisën marshimin për të hyrë në luginën e Lumit të Vlorës. Ata mbasi u informuan nga një pjesë e parësisë së Vlorës, nuk kaluan në ato qafa dhe gryka ku i prisnin kryengritësit, por kaluan në drejtime të tjera dhe u futën në Mesaplik. Këto forca osmane, u pritën nga forcat kryengritëse në Horë, ku u zhvillua një betejë e përgjakshme: *Në urë të Bratit u hodhë / Mesaplik ngul taborë/ Ngritën çadrat në Horë...*

Fshatarësia e Vlorës u tradhtua nga një pjesë e feudalëve vendas, u vendos në brendësi të maleve, dhe që andej me shkathtësinë e guximin që i karakterizonte, godisnin befasisht ushtritë osmane. Lufta e përgjakshme në Horë, pastaj në Bogdanë të Smokthinës e më pas në Gjomiha, vend mes Vranishtit dhe Tërbaçit. Në këto luftime trimëri të rrallë treguan luftëtarët tërbaçiotë, vranishnjotë, smokthinjotë, që i njihnin mirë shtigjet malore. U dallua Lulo Abazi, Haxhi Hoxha, Dule Koka, Dino Dreri, Mete Çobo, Beqir Selimi, Leskodukajt e Bolenës etj.

Kryengritësit, përdorën me shumë sukses taktikën e luftës së çetave, sulmo, shkatërro, mbill panik, tërhiq, godit natën edhe ditën, godit kampin dhe karvanët armik, tërhiq ushtrinë e tij nëpër prita, qëlloji dhe shpartalloji. Shtigjet verore i kishe zënë Dule Koka me trimat e tij. Kurse Dino Dreri me luftëtarët vraishnjotë dhe të Mavrovës, me komandantët e tyre, Mete Çobo dhe Hito Dauti, kishin zënë vendet më të rrezikshme. Komanda osmane hodhi kundër kryengritësve forca të mëdha, të freskëta, por përsëri nuk pati sukses: *Që nga Bogdani në Horë / Luftove me tre taborrë / Dueo Koka e Dino Dreri / Sokëllinë sa tundej vendi / Bogdan Dulo*

Kokë Trimi / Gjomihë Beqir Selimi / Dhe në Gjomihë u ra/ Trimi Mete Çobua...

Edhe pse s'ka shumë dokumente, këngët e shumta popullore flasin qartë për këto luftime, sa të përgjakshme aq edhe heroike, ku burojtë si ujët e gurave të maleve, heroizmi popullor, ku u shquan Lilo Qëndro, shënjtues i shkëlqyer nga Brati, Haxhi Hoxhë Smokthina, Mehmet Drashovica, Mustafa Begë Sevasteri, Dalip Çelo Mavrova, e qindra e qindra luftëtarë të tjerë: *Leskodukajt të shtatë / Luftuan me një rigatë / ...Ç'është ajo që shkoi tutje / Pallë e larë e Leskoduqe/ Vetëtimë supe më supe...*

Përkrah trimave të Lumit të Vlorës, luftonin edhe trimat e Bregdetit me në krye kapëdanin e tyre: *Gjikë Thanasi vetë i pestë/ Griu e vrau pesëdhjetë...* Luftimet u shtrinë përgjatë gjithë lumit të Shushicës. Ushtritë turke duke mos shtypur dot këtë kryengritje, dogjën fshatrat, Dukat, Tragjas, Tërbaç, Mavrovë, një pjesë të Vranishtit, Kuçin, Kallaratin dhe Bolenën.

Në grykën e Kuçit, forcat turke u ndeshën me trimat e Gjolekës: *O Gjolekë me kalë të verdhë / Prit nizamët se t'u derdhë / Të vijnë mirë se vijnë/ Jo me qindra por me mijë...* Zenel Gjoleka, një nga trimat e shquar, "pallë-zhveshur", udhëheqës kryesor në kryengritjen kundër Tanzimatit, ishte i bindur dhe i ndërgjegjshëm për luftën që bënte; ai rridhte nga shtresat e varfra të Kuçit, prandaj luftonte për shqiptarin e lirë, për të mirën e popullit fukara: *U trete Gjolekë u trete / Po sos u trete për vete / Për nizamë e për xhelepe / As për mua as për ty / Por për gjithë Shqipëri...*

Edhe pse dështoi kryengritja e fshatarësisë së Labërisë dhe Shqipërisë së Jugut kundër reformave të Tanzimatit, ajo pati rëndësi të madhe sepse u shpejtua forcimi i unitetit kombëtar, u rrit në një shkallë të lartë ndjenja kombëtare e popullit tonë për liri dhe pavarësinë e vendit. Ishte piketim i ngjarjes tjetër të madhe të këtij shekulli, Lidhjes së Prizrenit. Nga mesi i shekullit të XIX, në gadishullin e Ballkanit, u acaruan së tepërmi kontradiktat midis monarkive ballkanike. Rreth vitin 1854, qeveria greke organizoi

çeta të shumta, të komanduara nga oficerë të karrierës që u futën në tokat shqiptare, deri në fshatrat e Lumit të Vlorës dhe në Bregdetin e Himarës. Por vërshimin e këtyre bandave greke, popullsia e Shqipërisë së jugut e priti me luftë, në udhëheqje të kryengritjes u vu Mahmut Bej Vlora, Selim Pashë Vlora, Çelo Picari, Selam Hasani nga Velça, Haxhi Hoxha nga Smokthina, Dudë Sinani nga Gumenica, Ahmet Capari, Hasan Cako, Çobo Demiri, Shako Xhaka nga Tërbaçi etj., shumica e të cilëve kishin marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1847.

Më 12 mars 1854, forcat kryengritëse u hodhën në krahinën e Himarës, dhe atje së bashku me forcat beratase dhe trimat e Bregdetit, të udhëhequra nga Mahmud Bej Vlora, Sokrat Leka nga Qeparoi dhe Mëhill Qirjaqi nga Çorraj, i hodhën në det bandat greke, duke i bërë pluhur e hi synimet e tyre grabitqare.

Lidhja e Prizrenit më 1978, dhe vendimet që mori ajo, u përhapën shpejt edhe në Labëri. Fshatarësia e krahinës së Vlorës, nëpër mbledhjet që organizoi shprehu gatishmërinë për të zbatuar vendimet e rëndësishme të Lidhjes; në një nga këto mbledhje u ndodh edhe një nga udhëheqësit kryesorë, Abdyl Frashëri: *Kurvelesh e Gegëri / Çu mblodhë në Ergjeri / Ku Abdyl Frashëri / Luftoi për Shqipëri...* Vendimet famëkeqe të Kongresit të Berlinit për t'i dorëzuar Plavën dhe Gucinë dhe më vonë Hotin dhe Grudën Malit të Zi, vendime që u ngritën nga grykët e pushkëve të malësorëve trima, dhe midis tyre edhe shumë fshatarëve të Labërisë, që shkuan në ndihmë të vëllezërve të tyre të Veriut.

Vatra të pashuara kryengritjesh, e konfliktesh të armatosura me Turqinë, mbeten në malësitë shqiptare të Kosovës, Labërisë, Lumës, Mirditës, Sulovës e Shkodrës, të cilat nuk pranuan asnjëherë të zbatoheshin në krahinën e tyre vendimet ose dëshirat e Portës së Lartë. Gjatë viteve 1891-92-93 e deri në 1895, kryengritje të mëdha shpërthyen në malësitë e mbi Shkodrës, që u përhapën në të gjithë veriun dhe që u përhapën edhe në jug. Labëria dhe Himara, ishin gjithmonë një kazan i zjarrtë kryengritjesh të një pas

njëshme. Autoritetet turke, u përpoqën shumë gjatë këtyre viteve të likuidonin privilegjet e krahinës së Labërisë. Ato më 1890 thirrën në Gjirokastrë 24 krerë të kësaj krahine të cilët i arrestuan në pabesi, por në sajë të protestës, dhe kryengritjes së fshatarësisë labe, ata u liruan. Më 1895, kjo krahinë i dërgoi portës së lartë një peticion ku i kërkoj të mos cenoheshin privilegjet e tyre. Me fillimin e nëntorit, 1897, ndërsa në Vlorë, Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë, Delvinë bëheshin plane për të liruar të burgosurit dhe të internuarit, Labëria rrëmbeu armët për të mbrojtur vendimet e tyre që kërkoheshin të cenoheshin nga Porta e Lartë. Në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XX, ndërgjegjija kombëtare e shqiptarëve u rrit së tepërmi. Në verën e vjeshtës të vitit 1901, pakënaqësia në tërë Shqipërinë u bë e përgjithshme. Popullsia në krahina të tjera, nuk pranonte t'i jepte taksa dhe ushtarë qeverisë turke. Në Shkodër kryengritësit rrethuan qytetin, ndërsa në Shqipërinë e jugut, kryengritësit labë, u vendosën mes Tepelenës dhe Vlorës, ku u zhvilluan përleshje të ashpra me forcat turke, duke i shtrirë veprimet e tyre që nga Konica deri në afërsi të Elbasanit.

Në prill të vitit 1907, u nis nga Italia dhe zbarkoi në bregdet të Himarës çeta e Çerciz Topullit. Me të u bashkuan edhe shumë fshatarë vendas, të cilët, mezi prisnin të kryqëzonin armët me Turqinë; kënga popullore e ka përjetësuar këtë moment: *A me shtatë a me tetë / Na erdhi Çercizi vetë / U mblodhën djemtë e pleqtë...*

Në vitin 1908-09, për dy herë me radhë, u gjet në mes të fshatarëve të Vlorës plaku i shquar Ismail Qemali. Ai bisedoi në Vranisht me krerët e gjithë krahinës, për qëllimin e pavarësisë së Shqipërisë, dhe fshatarësia labe u përgjigj: *Burra të dalim në male / Turkun ta zhdukim fare...* Menjëherë filluan të ngriheshin çetat e para kryengritëse, për t'u përmendur, çeta e Vranishtit më 1908 me komandant birin trim të këtij fshati Sali Muratin, çeta e Zaçe Xhelos në Mesaplik dhe ajo e Beqir Velos në Kaninë. Viti 1910, filloi në gjithë Shqipërinë, me kryengritje të ashpra kundër turqve, që nga veriu në jug. *Nëntë qind e dhjetë viti / Thanë Himara krye*

ngriti / Ndaj u çkul mytesarrifi/ Asqer nga Preveza ngriti / U çkul e erdhi Himarë / Me topa me xhepehanë...

Kryengritja e vitit 1911, e gjeti fshatarësinë labe në këmbë me armë, për të çliruar qytetin e Vlorës, por në korrik, kur do bëhej sulmi mbi Vlorë, u zbulua dhe kështu plani dështoi. Në fund të korrikut u bë një mbledhje e madhe, me fshatarët kryengritës në Drashovicë ku u shpreh solidariteti me malësorët e veriut dhe vendimi ju dorëzua përfaqësuesve të shteteve të huaja në Vlorë. Edhe pse dështoi kryengritja e vitit 1911, ajo pati rëndësi të madhe, sepse qe baza për nisjen e kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912.

Udhëheqësit e kryengritjes së Shqipërisë së jugut u mbledhën me 23 korrik në Sinje, ku hartuan një memorandum për 12 pikash. Me anë të tij, paralajmërohej Stambolli se kryengritësit do të vazhdonin të qëndronin maleve me armë, derisa Porta e Lartë të merrte parasysh kërkesat shqiptare. Ky memorandum iu dërgua Stambollit më 28 korrik nga Vlora me telegram dhe nga një kopje ju dha përfaqësuese të huaj në Vlorë.

Më 25 korrik të këtij viti, çeta e Vranishtit me në krye kapedan Sali Muratin, e çliroi përkohësisht qytetin e Vlorës, hapi burgun dhe i liroi të burgosurit: *Hapsanatë kush i hapi/ Kapedan Sali Murati...* Forcat turke u munduan që ta shpartallonin këtë çetë, por nuk ja mbërritën dot qëllimit: *Në rrap e varën fermanë/ Të ziri Sali Muranë/ I rrethosën në Qishëbardhë / Po s'u qaseshin dot pranë...*

Fshatarësia kryengritëse e Labërisë e priti me gëzim dhe entuziazëm të papërshkruar ardhjen e patriotit Ismail Qemali në Vlorë, dhe ngritjen e flamurit më 28 Nëntor 1912. Ata e pritën shpalosjen e flamurit me fluturimin e shqiponjës në qiellin e lirë të Shqipërisë më krisma armësh, me këngë zemrash: *Smail Qemali në Vlorë / Bashkë me shokët e tija/ I tha popullit me gojë / Poshtë o shokë robëria / Evropa le ta dëgjojë/ Nuk ka vend këtu Turqia...*

Dhe betimi i Labërisë dhe i gjithë popullit shqiptar në këtë ditë historike ishte: *Ja të vdesim ja të rrojme / Është e jona Shqipëria...*

Vlorë, qershor 1987

SI I KA PËRJETËSUAR LUMI I VLORËS HISTORINË DHE LUFTËTARËT E VET NË KËNGËT E TIJ¹

Lumi i Vlorës vendosur mes malesh të ashpra, duket si kështjellë e vërtetë natyrore e Labërisë, me malet e Kurveleshit në verilindje, dhe të Çikës në jugperëndim, në shekuj ka lindur dhe ka rritur labë të ndershëm dhe patriotë të fuqishëm, si vetë shkëmbinjtë e këtyre vargmaleve, prandaj poeti popullor, nocionin gjeografik e jep në harmoni me cilësitë moralo-politike përmes vargjeve: *Labëri shkëmbenj e male / Nënë trimash kreshnikë / Me gjak truallin e ke larë / Ndaj liria të puth sytë...*

Liria dhe pavarësia e atdheut erdhi edhe si rezultat i lufërave dhe përpjekjeve të banorëve të Lumit të Vlorës, në rrjedhat e shekujve. Ende në këto brigje e gryka, vringëllojnë armët e Zenel Gjolekës, Cane Miftarit, Lulo Abazit, Shako Xhakës, Selam Hasan Velçës, Haxhi Hoxhës, Mete Çobo Vranishnjotit, Leskodukajt e Bolenës, të cilët luftuan përballë hordhive të shumta osmane që mbanin vendin të robëruar.

Një shpirt i tërë popullor në kryengritjet e mëdha antiosmane, u derdh nëpër llogoret e luftës sepse e donte si askush këtë tokë të shtrenjtë. Kjo jehonë dhe ky shpirt i madh kombëtar, u ushqye nga brezat më vonë. Janë ata firarët që dalin maleve për të luftuar me “halldupin”. Luftëtarët Mehmet Hyseni në Kuç, Sali Kapedani në Vranisht, Alem Mehmeti në Tragjas, dhe Odhise Kasneci në Bregdet. Dukej sikur jehona e krismave të tyre për liri dhe pavarësi, përcillej nëpër shpatet e historisë kombëtare. Kjo frymë liridashëse ushquu luftëtarët e epopesë së njëzetës, me Osmën Haxhiun kundër pushtuesve italianë.

¹ Ky punim është mbajtur në takimin përkujtimor të rënies në luftë të dëshmorit Shaban Seferi, në Val të Bogonicës, ku ishin të pranishëm edhe bashkëluftëtarët e tij Mantho Bala, Ymer Veshi, Çobo Osmëni, e poeti popullor Lefter Çipa.

Nga gjiri i popullit dolën qindra prijës dhe komandantë, të cilët u bënë strategë të shquar ushtarakë të kësaj lufte të madhe popullore. *Ata bujqër dhe çobanë / Që s'pyetën për miliona / Mbi tela, mbi istikamë / Ja vdekje, ja Vlorë jona...* E në vitet e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, bijtë e lumit të Vlorës e të Labërisë, u bënë luftëtarë dhe prijës të shquar kundër kuçedrës nazifashiste.

Lufta e Dytë Botërore, gjeti në Lumin e Vlorës, një vatër të ndezur të luftëtarëve anti-fashistë. Në këtë luginë u krijua Çeta Plakë, dhe çetat “Zigur Lelo”, “Sali Murati”, “Halim Xhelo” dhe batalioni “Ismail Qemali”. Pushtuesi nazifashist hasi në rezistencën e vendosur antifashiste të banorëve të kësaj treve, e cila është ushqyer me tradita liridashëse prej shekujsh.

Labëria i ka të gjalla aktet heroike dhe i ka përjetësuar në këngën e saj. Mbi çdo gur Labërie, vizatohet portreti i një luftëtari, të rënë për lirinë dhe pavarësinë e atdheut! Poeti popullor ka shprehur: *Kuçi në rreze të malit / O vendi shqiponjave / Do këndoj një këngë malli / Për dëshmorët që ke / Kush e dha jetën i pari / Shate Rrokua lule / Mitat, Ali e Jashari / Luftëtarë që të tre / Memo Meto atdhetari / U bë ashtu siç na the...*

Analogjia e shkëlqyer, vendi i shqiponjave ka nxjerrë patriotë dhe luftëtarë, që tek epiteti atdhetari, jepte sinteza se atdheu, Shqipëria, që i nxisnin këta martirë të Lumit të Vlorës, të binin në beteja kundër pushtuesve nazifashistë. Ashtu si edhe në këngët e mëparshme, trimat janë të tërbuar, ata luftojnë dhe vdesin për ideale të mëdha kombëtare. Kënga për Hysen Çinon, këtë luftëtar të shquar, është përherë e gjallë dhe këndohet ndër vite në buzët dhe shpirtrat e labëve: *Hysen Çinua trim me fletë / Hysen Çinua i tërbuar / Ishte plagosur në duar / Po nga lufta s'kish ndaluar / Qajnë malet për Hysenë / Se s'vjen më si ato herë...*

Populli me këngën e tij, përmes epitetit “i tërbuar” jep cilësitë që e karakterizojnë birin e fshatit Vranisht, Hysen Çinon, që edhe pse me duart tërë plagë nga përplasja në beteja, nuk tërhiqet nga lufta. Kënga tregon se edhe malet dhe lugjet vajtojnë për të, sepse u dhimbjes jeta e tij e re. Por mbi të gjitha ngrihet akti i tij i trimërisë, ideali i tij i madh i luftëtarit antifashist për liri dhe pavarësi. Hysen

Çinua me brezin e tij, mori udhët nga Labëria e deri në Kukës e Kosovë, për të shpërrur bishën naziste që kish zaptuar vendin. Portreti i tij i bukur si komandant dhe luftëtar, jepet gjithmonë me ngjyra epike.

Në shtratin e saj kënga popullore ka gdhendur me vargje monumentale Memo Meton, Fejzi Micolin, Resul Veliun, Hajredin Bylyshin, Shaban Seferin, Qeriba Derrin, Mumin Selamin, Bajram Tushen e qindra e qindra të tjerë, të cilët flenë në lëndinat e lirisë me idealet dhe plagët e tyre të bukura: *Moj Lufta e Dytë Botërore / Të bukur trima që more / Një nga një me dorë i zgjodhe...*

Dëshmorët e Luftës së Vlorës edhe në këngë rrinë së bashku, si në një kopsht të bukur lirie. Ata u njohën në udhët e tyre Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i bashkoi gjaku i derdhur në themelet e lirisë së vendit. Ata na duken më shumë sesa shokë, ata janë më shumë sesa vëllezër: *Mesapluku kjo krahinë / Të bukur trima të iknë / Hysen Çino me Qamilë / Kamber Rustemi Smokthinë / Në Tërbaç Resul Velinë / Meqir e Myrte Sadikne / Brataj Bajram e Refikne / Dhe Laze Nuro bilbilë / Në Gjorm Bako Tafilë...*

Dhanë jetën për lirinë, jepen në këtë këngë dëshmorët e çdo fshati, bëhet një zbrëthim i vargut të dytë “të bukur trima të iknë”. Shaban Seferi, student i mençur, poeti partizan, një nga ilegalët dhe dëshmorët e parë të Vranishtit, në çastin që u vra, mendonte për dy shokët nëse shpëtuan apo jo, nëse i shpëtuan materialet. Atij nuk i dhimbsej jeta e re, se ishte i bindur se ideali i tij do të triumfonte: *28 nëntori o viti 42 / Në një mal se ç’u ndez flaka / Në Vranisht një djalë i ri / Vetë i qetë në ca qafa / Luftoi më trimëri...* Kështu i ka kënduar poeti popullor Vranishtit më datën e shënuar të 28 nëntorit, Shaban Seferit, të rënë heroikisht në valin e Bogonicës më 21 gusht 1942. Me vargun “28 nëntori” këngëtari popullor nuk flet për koincidenca të datave historike, pasi në këto male ku pushka partizane shkrepse fuqishëm, nuk ka datë pa histori, se Lumi i Vlorës, si tërë Labëria, si e tërë Shqipëria, është e mbushur pëllëmbë me histori.

Fashistët italianë, dhe bashkëpunëtorët e tyre e çuan trupin e Shaban Seferit të vrrarë në Vuno për të trembur bregdetasit e papërkulur, për tu mbushur mendjen atyre se kush ndjek rrugën

e Shabanit dhe shokëve të tij, ai fat do t'i gjente. Por, fashistët gaboheshin. Sepse populli i Bregut dhe ai i Lumit, dhe i gjithë trualli arbëror, ka lindur dhjetëra Shabanë të tjerë që thërriteshin Zaho Koka, Llambro Andoni, Spiro Gjikhuri, Sefo Meksi, Memo Meto e të tjerë. Sa bukur e simbolisht flet kënga: *Zaho Koka xhevahiri / Në ballë të digjej ylli...*

Ky ishte ylli i partizanit që derdhi gjakun kundër fashizmit. Në përgjigje të vrasjes së Shaban Seferit, Zaho Koka me djemtë e Bregut, do të kryenin aksionin për vrasjen e Tenente Moretti-t: *Haka shpejt ju muarr / Nga trimi i Bregdetit / Pushkë e Zaho Kokës / Në Vishë e shtriu Moretin...* Andej për labin këndohen trimëritë e Hysenit, Muminit, Mitatit, Hajredinit, Shabanit dhe njëherazi me ta edhe emrat e Zahos, Persefonit, Vojos, Qemalit se trimat e Shqipërisë janë edhe bijtë e Labërisë.

Familja labe nuk e ndihmoi luftën antifashiste nacional-çlirimtare vetëm me nga një përfaqësues nga çdo derë, por fronti i rezistencës antifashiste ishte i gjerë, dhe malet, dhe gurët, dhe drurët, dhe gërxhet, dhe shkrepat u bënë shembull qëndrese, djep lirie. Gjeografia e luftimeve e mbulon hartën e Labërisë. Figurat e shquara antifashiste janë një shembull i gjallë, në të cilin mishëroheshin idealet e një bote të re, për një Shqipëri të lirë dhe demokratike: *Ju kish rritur nëna / Për një botë të re / Lule more trima/ Që ratë për atdhe...* Me armë në dorë bie Shaban Seferi, në gjurmët e tij ecën edhe vëllai i tij Laze Seferi, komandant i kompanisë së parë të batalionit të katërt të Brigadës së Pestë Sulmuese. Gjaku i Lazes, më 28 janar 1944, në Brashec të Bratit, skuqi gurët që u kthyen në lapidar. Prandaj rapsodi, bashkëluftëtari i tij me nota të gjalla, e përjetësoi rënien heroike: *Në maja të Borshe / Flakë e tym i zi / Janë partizanët, që luftojnë aty / Është Laze trimi, me gjithë kompani...*

Nga thellësitë e shekujve vijjnë tek ne këngët e trimave, këngë për dëshmorët e Luftës Nacional-çlirimtare, të cilat ishin aq të dashura. Ato këngë u ngrohën buzët nëpër ngricat e kohës. I mbanin në torba me fishekë dhe shumëfishonin optimizmin në luftën kundër pushtuesve armiq. Ishte tetori i vitit 1942 kur katër djem luftëtarë

me zemrën zjarr e barot, do të shkruanin një epope: *Studentët mirë qëndruan / Hajredini me Muminë / Bajram Tushi nga Vërmiku / Kush nuk ua di historinë ...* Hajredin Bylyshi lindur në fshatin me tradita të lashta të Tërbaçit, i edukuar që në fëmijëri me dashurinë për lirinë e atdheut, më urrejtjen për armiqtë dhe pushtuesit, ata qëndroi së bashku me tre shokët e tij, Mumin Selamin dhe Bajram Tushin dhe Hiqmet Buzin, ashtu siç u ka hije trimave, duke e kthyer shtëpinë e vogël në Topana, në kala ku luftonin kundër katërqindëve.

Dhe bukurinë e betejës këngëtarit tërbaçiot e ka hedhur në bukurinë e këngës: *Kush është vrarë më parë / Hajredin Nurua në Vlorë / I dyti Beqir Selimi / Vrarë në luftën në Gjorm...* U këndojnë tërbaçiotët dëshmorëve të fshatit të tyre, me nderim dhe krenari, për aktet e rralla të heroizmit që ata treguan, në qafën e Këçikut: *Shtatë qershor 44/ Gjithë Tërbaçi ra në zi / Qajnë Skëndojt Nysretinë / Bonjakun që çilimi / Rrugën e Halimit mori / Ç'i nderoi dhe ai / Çdo t'i harrojte më parë / Djaloshit Hodo Sabri ...* Dhe isoja e këngës labe ka ushtuar dhe ushton gjithmonë për heronjtë e dëshmorët: *Bogonica me Çipinë / Ç'ka që qajnë me lot / Qajnë me lot për Muminë / Që s'e shoh në këtu sot...* i këndojnë kallaratasit birit të tyre të dashur, që me idealet e lirisë në mendje dhe në zemër, nuk e kurseu jetën e tij të re. Liria i ka rrënjët në gjak, ajo u fitua me jetën 28 mijë të rënëve në luftën e madhe nacional-çlirimtare. Prandaj gurra popullore ka skalitur: *O Vranisht nuri me halle / Dje në luftën çlirimtare / Tu vra ajka e djalërisë / Për lirinë e Shqipërisë/ Hallall ju qoftë ajo sisë...*

Kështu u kanë kënduar nënat labe heroína të Lumit të Vlorës, djemve të tyre dëshmorë; kështu u kanë kënduar të gjitha nënat shqiptare, sepse bijve të tyre së bashku qumështin e gjirit, u kishin mëkuar traditat më të mira të të parëve, trimërinë, besën, guximin dhe atdhedashurinë. Nënat labe jo vetëm i lindën dhe rritën bijtë e tyre, i mëkuan dhe edukuan, por ato qenë pranë tyre në luftën e madhe: *Përcolle birin e vetëm / Partizanë me shokë në çetë / Për lirinë e mëmëdheut / I more malet përpjetë / Flamur të bukur qëndise / Hodhë shkabën me dy krerë / Dhe u nise për tek djemë / Ballin dritë e këmbët erë...*